



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.08.2016, ora 11:25

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të komisionit.
2. Vazhdimi i shqyrtimit të projektligjit “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtareve dhe Prokurorëve në RSH”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Arben Ristani, Fatmir Mediu, Gent Strazimiri, Keltis Kruja.

Mungojnë:

Spartak Braho

Të ftuar:

Richard Regner, ekspert i nivelit të lartë.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Meqenëse kuorumi i nevojshëm për fillimin e mbledhjes është i realizuar, nisim mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Siç është e njohur, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 22 korrik ka miratuar ndryshimet kushtetuese, ose ndryshe paketën kushtetuese për reformimin e sistemit të drejtësisë. Natyrisht, zbatimi i kësaj pakete të rëndësishme, që synon dhe shpresojmë të realizojë një reformim thelbësor dhe të rëndësishëm të sistemit, por jo vetëm të sistemit të drejtësisë, është e nevojshme të shoqërohet me një paketë projektligjesh, të cilat do të bëjnë të mundur jo thjesht dhe vetëm zbatimin e normave kushtetuese, por edhe një reformim sa më të plotë të sistemit. Nuk janë pak, por janë rreth 50 ligje, që janë hartuar dhe janë në procesin e shqyrtimit, nga të cilat 7 janë konsideruar si ligje prioritare, sepse nga njëra anë janë ligje që bëjnë të zbatueshme normat kushtetuese për reformimin e sistemit të projektit kushtetues, por nga ana tjetër hapin rrugën për reformimin tërësor të sistemit, në mënyrë të veçantë për ngritjen e institucioneve të reja të sistemit. Janë 7 projektligje të rëndësishme, të cilat nga pikëpamja procedurale kemi pasur rastin t'i trajtojmë, t'i prezantojmë, t'i shqyrtojmë në parim dhe nen për nen në këtë projekt. Natyrisht, nuk kishte si të votoheshin për shkak se kemi qenë të vetëdijshëm që do të lidheshin me miratimin e projektit kushtetues. Kemi qenë të vetëdijshëm se ndryshimet kushtetuese do të duhej të reflektoheshin në këto 7 ligje bazë, që janë ligje të rëndësishme dhe që kanë të bëjnë, siç edhe e thashë, me implementimin e projektit kushtetues, kanë të bëjnë me fillimin e procesit të reformimit të sistemit, me ngritjen e institucioneve të reja, por natyrisht, siç është bërë e ditur edhe publikisht, ka të bëjë edhe me një kushtëzim të Komisionit European, që lidhet me hapjen e procesit të negocimit. Të gjitha këto janë arsye më se të mjaftueshme që ky komision, në respekt të Kushtetutës, t'i japë të gjithë kohën e nevojshme, të gjithë angazhimin e duhur procesit për miratimin e këtij kuadri ligjor të rëndësishëm, për të vazhduar pastaj me pjesën tjetër të paketës së projektligjit për reformimin e sistemit. Ndër to, ligji numër 1, po e quaj, jo për shkak të rëndësisë të veçantë që ka nga ligjet e tjera, por për shkak të kohës ose më saktë të vetë natyrës së procesit të implementimit, të metodologjisë dhe të kronologjisë, është ligji i vetingut, për shkak se mbi këtë ligj do të duhet të ndërtohen institucionet e reja. Nëse nuk realizohet procesi i vetingut, do të jetë shumë e vështirë për të ngritur institucionet e reja të sistemit. Ka përparësi edhe nga pikëpamja e kronologjisë së procedurës kushtetuese është

ligji që i ka afatet të tilla, pra që është i pari në radhë për t'u implementuar, edhe për shkak se ky ligj ka të përfshirë Brukselin, pjesën ndërkombëtare, pra ekspertizën dhe asistencën ndërkombëtare të Brukselit në radhë të parë, por edhe të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët do të përfshihen në procesin e vetingut nëpërmjet Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Ka përparësi edhe për shkakun se ky është një projekt që financohet kryesisht nga Brukseli. Është një projekt që do të duhet të marrë kohën e vet për të rekrutuar burimet njerëzore të nevojshme, pra prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë që do të përfshihen në këtë proces. Kjo është arsyeja që ky është një projektligj që ka prioritet në radhën e projektligjeve të tjera që do të shqyrtohen.

Siç jeni në dijeni, lidhur me këtë projektligj është paraqitur një projekt fillestar në mesin e muajit qershor, i cili është prezantuar nga ekspertët, kryesisht nga ata të misionit EURALIUS, por edhe OPDAT-i ka qenë i përfshirë, nga ekspertë vendas të sekretariatit teknik, të cilët kanë punuar gjithashtu me këtë projekt. Në fakt, kemi bërë disa diskutime për këtë projektligj, janë bërë vërejtje dhe sugjerime, njëkohësisht projekti kushtetues, posaçërisht për pjesën që kishte të bënte me aneksin, me vlerësimin, ka bërë disa ndryshime në momentin e fundit, që janë reflektuar në versionin final, në projektin final, të miratuar nga Kuvendi, të cilat, gjithashtu do të duheshin të reflekttoheshin në projektin që do të shqyrtohej projektligji. Për këtë arsye këto reflektime janë bërë, në mënyrën sesi është gjetur e arsyeshme nga këndvështrimi i ekspertizës. Në datën 28.06 ky projekt është shpërndarë nga ekspertiza për të qenë në dispozicion të komisionit. Kolegët e Partisë Demokratike kanë pasur dhe kanë një opinion të caktuar lidhur me disa çështje ose me shumë çështje (kjo ngelet për t'u parë) që kanë të bëjnë me përmbajtjen e këtij projektligji, për të cilat jemi mbledhur sot, që janë për t'u prezantuar nga kolegët dhe më pas për t'u dhënë mundësi ekspertëve që të punojnë, pasi të njihen edhe me këto komente, sugjerime apo propozime konkrete që mund të ketë. Sot jemi këtu pikërisht për këtë fakt, për t'u njohur me qëndrimin e kolegëve përfaqësues të opozitës dhe, natyrisht, për të vazhduar më pas për procedurat e mëtejshme për shqyrtimin e projektligjit.

Dua t'ju vë në dijeni të faktit, për të qenë transparent për efekt të mbledhjes, por jam i bindur se tashmë ju jeni të informuar, që lidhur me këtë proces janë përfshirë aktivisht drejtuesit, lidërshiptet politike të forcave kryesore politike në Kuvend për të gjetur një gjuhë të përbashkët dhe për të përshpejtuar procesin në funksion të nevojës që kemi, siç e parashtrova më lartë, si edhe dy përfaqësuesit e partnerëve strategjikë, të angazhuar aktivisht në këtë proces, të Bashkimit

European dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dy ambasadorët respektivë në vendin tonë. Për faktin se në tërësi kjo paketë projektligjesh që do të shqyrtojmë, në mënyrë të veçantë 7 projektligjet, por specifikisht projektligji për të cilin jemi mbledhur sot, projektligji për vetingun, ka të përfshirë kontributin e tyre të drejtpërdrejtë, edhe për shkak të faktit që do të jenë pjesë subjekt i implementimit, i zbatimit të këtij procesi të rëndësishëm të gjithë bashkë jemi dakordësuar për të ndjekur disa hapa proceduralë, duke filluar nga kjo mbledhje e sotme e këtij komisioni, ku do të prezantohen qëndrimet, komentet, sugjerimet, propozimet që mund të kenë kolegët e opozitës për t'iu dhënë në vazhdim mundësi ekspertëve për t'i shqyrtuar që të rimbledhemi këtu për ta diskutuar dhe për t'i dhënë formën finale projektit. Më pas ky projektligj, me një apo dy projektligje të tjera, të cilat janë, gjithashtu, të rëndësishme do t'i drejtohen seancës në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, pa dyshim brenda muajit gusht në një seancë të posaçme për t'u shqyrtuar dhe miratuar.

Kjo është për të informuar kolegët lidhur me procesin e deritanishëm dhe mbi atë çfarë është gjykuar ose është dakordësuar për të vazhduar më tej. Besoj se është më se e mjaftueshme kjo që prezantova dhe tani i mbetet zotit Bylykbashi për të bërë prezantimin përkatës.

Oerd Bylykbashi – Të nderuar kolegë,

Sot është hapja e një procesi të ri, e një faze të re të reformës në drejtësi, ajo që vijon pas përmbjlljes me konsensusin, praktikisht me unanimitetin e parlamentit shqiptar, aprovimi i dispozitave kushtetuese. Sot kemi një paketë kushtetuese të plotë, pavarësisht mendimeve teknike që mund të kemi për të, e rëndësishme është vullneti politik që ka mbështetur këtë paketë. Sigurisht, kjo e bën më të thjeshtë të gjithë punën tonë, nuk ka të njëjtin nivel të diskutimit dhe debatit politik, siç ka qenë ai diskutim mbi atë paketë. Sigurisht, është edhe një proces shumë teknik dhe shumë profesional për të gjithë këto ligjet që ne duhet të shqyrtojmë. Megjithatë, detyra jonë kryesore është që këto ligje të jenë në përputhje të plotë me atë që parashikon tashmë Kushtetuta, asgjë që del jashtë saj, qartazi me parimet, me principet ndërkombëtare, standardet ndërkombëtare, që janë të paraqitura shumë mirë, kryesisht në opinionin përfundimtar të Komisionit të Venecias.

Besoj se duke ecur në këtë hulli ose në këtë themel tashmë të vënë që është Kushtetuta, besoj që me mirëkuptim dhe konsensus ne do ta gjejmë rrugën shpejt drejt përfundimit të këtyre dispozitave. Një dakordësi që është theksuar edhe këtu në komision më herët, ka qenë ajo që Kushtetuta, paketa kushtetuese dhe shtatë ligjet kryesore do të dakordësoheshin në komision me

konsensus përpara se t'i drejtoheshim Kuvendit. Rrjedha dhe rrethanat e sollën të tillë që tashmë kemi Kushtetutën, pra na bie barra të tregojmë kujdesin maksimal dhe vullnetin pozitiv të gjitha palët, që edhe këto shtatë ligje kryesore me qëllim që t'i qëndrojnë kohës nëpërmjet konsensusit, parimeve, standardeve dhe ekspertizës ndërkombëtare të vazhdojnë në hullinë e konsensualitetit. Unë shpreh gadishmërinë tonë për këtë, besoj se ne do të arrijmë që me punë të përbashkët të shkojmë. Kjo është një gjë e thënë në komision më herët, i qëndrojmë kësaj.

Në këtë aspekt desha fillimisht, për ta kthyer në praktikitet punën e komisionit sot, duke filluar nga ky ligj dhe më pas për të ecur edhe me ato që përmendi kryetari, me ligjet e tjera që do të vijojnë, kryesisht dy ligjet e tjera që janë me një lloj prioriteti më të madh, unë gjykoj se sot është me vend që ne, opozita t'i parashtrijmë çështjet në princip, që ne i kemi konsideruar si çështje, të cilat duhet të trajtohen me seriozitet, kërkojnë një diskutim dhe dakordësi në teknikë dhe qartazi më pas politik këtu në komision për një seri çështjesh. Pra, do të trajtojmë aspektet principiale sot, ndërkohë sugjeroj që aspekti teknik, pra të gjitha komentet që janë bërë nen për nen dhe paragraf për paragraf për këtë projektligj sipas problematikave kryesore që unë do t'i parashtrij, t'ua lëmë si detyrë ekspertëve që brenda ditës së sotme, të paktën duhet filluar që nga sot, t'i shkëmbejnë këto aspekte, këto vërejtje, këto çështje, eventualisht edhe formulimet, në mënyrë që të gjendet një gjuhë teknike për t'ia sjellë komisionit në versionin final që ne të japim mbështetjen tonë.

Zoti kryetar, besoj që për këtë, biem dakord të operojmë në këtë formë, ekspertëve t'i lëmë detajin, ndërkohë që ne të merremi me aspektin principial.

Në aspektin procedural, sugjeroj që në lidhje me dy ligjet që do të vijnë, do të doja të kishim në dispozicion versionin më të fundit, përfshirë edhe ndryshimet që mund të jenë bërë nga draftet që i janë dërguar fillimisht komisionit, siç është ky që pati pësuar ndryshime. Ju keni pasur mundësinë që të diskutoni dhe të fusni në projektligj pozicionet tuaja, gjë që është proces, i cili shpresojmë, që gjithashtu tani së bashku të diskutojmë edhe për pozicionet tona, por edhe të paktën për të dy ligjet e tjera që vijnë me prioritet, sa më parë t'i kemi versionet përfundimtare, në mënyrë që të kemi punë efektive dhe të shpejtë.

Qartazi, siç e thatë edhe ju, nuk mund të miratohej gjë para se të miratohej dhe të hynte në fuqi Kushtetuta. Sigurisht, kjo është sequenca, të miratohet Kushtetuta dhe të miratohen iniciativat legislative të bazuara në të. Pikërisht, mbi këtë gjë, besoj se do të gjejmë dakordësinë për të ecur shpejt për një kalendar, i cili do të na mundësojë eventualisht në një seancë të jashtëzakonshme,

në qoftë se brenda gushtit, për miratimin e këtij ligji, mundësisht edhe dy ligjeve të tjera. Pra, për ta mbyllur këtë aspekt procedural, unë po futem tani te paraqitja e problematikave kryesore.

Ky ligj që miratojmë sot, vjen sot i pari, për një numër arsyes, e tha edhe zoti Xhafaj është rëndësia e tij, është hera e parë që bëjmë një gjë të tillë, por kjo nuk do të thotë se do të jetë i pari, por edhe te kronologjia e veprimeve që do të ndiqen në këtë koncept të reformës në drejtësi, e kërkon që ky ligj, i cili do të shërbejë si një filtër i madh për sistemin, të jetë i pari, i miratuar, por sigurisht ne e dimë shumë mirë, diçka tjetër, të gjithë ne e dimë, pa përjashtim, vendas dhe ndërkombëtarë, ky është një ligj, i cili nuk ka një standard ndërkombëtar, nuk ekziston. Këtë e thotë edhe Komisioni i Venecias, nuk kemi pse ta shtojmë, e thotë qartë. Si i tillë, duke mos pasur standard ndërkombëtar, me ato pak raste, që në shumicën e rasteve janë problematike, që ekzistojnë në vendet e tjera, të paktën në zonat ku ne bëjmë referim për sistemet tona juridike, pra në zonën e Këshillit të Europës, nuk ekziston gjithashtu as praktikë e mirë, nuk ka *best practices*, së cilës t'i referohesh në mënyrë solide për të zgjidhur problemin që kemi. Si e tillë, besoj që rruga më e sigurt për të gjithë ne është kapja fort te parimet e shtetit të së drejtës, - pavarësisht gjyqësorit apo sistemit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut, të paktën këto të tria. Për sa kohë ne jemi të kujdesshëm që ato të cilat ka parashtruar Komisioni i Venecias, në opinionin e tij për Shqipërinë apo në dokumente të tjera referuese, po mbi të gjitha atë që parashikon Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, besoj se do të jemi në gjendje të hartojmë një ligj, i cili do t'i bëjë të dyja detyrat: do të pastrojë sistemin e drejtësisë nga ky problem i madh që ne kemi sot, korrupsionin, mbi të gjitha, por edhe paaftësinë, aty ku do të jetë e mundur të identifikohen pjesët më problematike, por nga ana tjetër, duke garantuar një proces të rregullt ligjor. Ky është një merak i madh i cilitdo profesionisti, por e thënë e zezë mbi të bardhë, shumë fort, edhe nga Komisioni i Venecias.

Pra, ne do të jemi duke bërë atë detyrë që mendojmë se duhet bërë patjetër, por duhet të kemi edhe këtë balancën e kujdesshme.

Në këto kushte, pra në mungesë të standardit ndërkombëtar, në mungesë të praktikave të mira, rruga më e mirë është që ne të kemi një ligj, i cili është jo vetëm i bazuar në parime, por të jetë edhe një ligj i hartuar mirë, shumë i detajuar dhe shumë i qartë.

Qartësia e këtij ligji dhe saktësia e tij lidhet drejtpërdrejt me atë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka konstatuar në vendimet e saj në të shkuarën, edhe me sigurinë juridike të sistemit. Ajo vetë pastaj, lidhet me konceptin e shtetit të së drejtës.

Kështu, na duhet të marrim në konsideratë çdo lloj problemi dhe çdo lloj detaji. Na duhet që, nëpërmjet një ligji të kujdesshëm e të detajuar, ne të garantojmë se këtë detyrë e bëjmë, pa ekspozuar më pas ligjin karshi çdo lloj problemi që mund të lindë nesër nga të tretët, të cilët pavarësisht konsensusit tonë, mund të kenë problemet e tyre me këtë ligj.

Kështu që, në këtë konsideratë të përgjithshme, unë besoj se biem të gjithë dakord. Këtu jemi profesionistë, përveçse me veshje politike. Ekspertët, gjithashtu, me formimin e tyre solid, janë të qartë në këtë.

Fatmir Xhafaj – Dy minuta pushim, ju lutem!

Dakord, vazhdojmë!

Oerd Bylykbashi – Ju kërkoi ndjesë, ishte diçka urgjente.

Po filloj me konsideratat e përgjithshme që opozita ka në lidhje me projektligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Së pari, ne gjykojmë që projektligji duhet të parashikojë në detaje të gjitha procedurat dhe veprimet që ndjekin strukturat e përfshira në procesin e vetingut. Sigurisht që në këtë drejtim merr një rëndësi shumë të madhe përcaktimi i afateve të qarta të veprimit të këtyre strukturave, procedurave të qarta deri në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, sepse në gjykimin tonë mungojnë afatet brenda të cilave duhet të përfundojë ky proces, për shembull, procesi i vetingut dikujt mund t’i fillojë në fillim të procesit dhe në mungesë të këtyre afateve mund të përfundojë në fund të afatit të parashikuar nga ligji, pra në fund të 5 vjetëve. Sigurisht që kjo do të krijonte një pezulli, një situatë pasigurie dhe eventualisht mund të krijonte edhe një presion mbi gjyqtarët dhe prokurorët në punën që ata kryejnë, pavarësisht nëse ata më pas do të rezultojnë të papërshtatshëm për sistemin ose janë të pastër dhe të aftë për të vazhduar këtë detyrë. Ky është një proces kompleks, dhe, si rrjedhojë, në mënyrë specifike, neve na duhet që ta strukturojmë në mënyrën më të detajuar të mundshme edhe këtë aspekt.

Një çështje tjetër që ne gjykojmë se është i një rëndësie themelore... pra, ne duhet t’u garantojmë statusin anëtarëve të organeve të vetingut. E vlerësojmë si të domosdoshme detajimin e plotë të të gjitha garancive për pavarësinë funksionale, organizative, buxhetore të institucionit të vetingut. Kështu që në këtë drejtim besojmë se rëndësi themelore ka përcaktimi i detajuar i rregullave dhe i rasteve të mbarimit të mandatit të anëtarëve të organeve të vetingut. Pra, të komisioneve të përkohshme të kualifikimit për hir të apelimit, të statusit të punonjësve të tyre, garancitë që do të bëjnë të mundur imunizimin dhe shmangien nga korrupsioni, apo abuzimi me detyrën. Për sa kohë

nuk u garantohen elementet që do të përcaktojnë qartë statusin e tyre dhe garancitë që e kanë detyrë, sigurisht që këto organe do të ishin vulnerabël jo vetëm ndaj korrupsionit, por ndaj presionit dhe kapjes politike. Kështu që ne gjykojmë se kjo është një mangësi që ka ligji dhe që mund të rregullohet me punë.

Ne, gjithashtu, mendojmë se rëndësi ka dhe mënyra se si do të bëhet procesi, qartësia, parashikueshmëria e procesit të vetingut. Ne jemi kundër idesë që vetingu të jetë rastësor, por të jemi përpara asaj që të gjithë duhet ta kenë të qartë, të gjithë do të kalojnë në veting dhe ky nuk është një short, pra, të gjithë, duke u nisur nga prioriteti që kanë institucionet, nga rëndësia në hierarkinë e sistemit. Atyre duhet t'u përcaktohet qartë një kalendar që ata do t'i nënshtrohen vetingut karshi kritereve që janë qartë në ligj dhe procedurave që janë në këtë ligj. Pra, gjithsekush duhet ta dijë dhe kjo nuk mund të jetë diçka e turbullt, e papërcaktuar e, për rrjedhojë, eventualisht mund të jetë edhe abuzive.

Bazuar në atë që thotë Komisioni i Venecias, duke qenë se ky është një proces i jashtëzakonshëm, duke qenë se ky është një proces i cili është shumë kompleks, nga ana tjetër gjykojmë se ky duhet të jetë një proces që duhet të ketë një masë të përgjithshme. Nuk është një lloj gjetie specifike, selektive, e qëllimshme. Në këtë filtër do të kalojnë të gjithë. E kemi pranuar që për interes të publikut do të kalojnë edhe ata gjyqtarë, edhe ata prokurorë të cilët janë të ndershëm, të aftë, të pakorruptuar. Por në çdo rast ne gjykojmë se, duke parashikuar në detaje masat që garantojnë një proces të rregullt ligjor dhe procesin e vetingut, ne do ta bëjmë të mundur që kjo të jetë një masë e përgjithshme dhe jo një masë e qëllimshme, selektive, në dorë të iks apo ipsilon force, ose institucioni që po e zbaton. Të mos harrojmë që fillojmë me një proces, i cili është administrativ që janë komisionet dhe më pas, siç thotë Komisioni i Venecias, duhet të ketë edhe një gjykatë që do të garantonte procesin më pas. Kjo është shumë e rëndësishme. Ne mendojmë se mospërshkrimi i detajeve për këtë aspekt do të krijonte eventualisht nesër probleme, përfshirë dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo nuk është një gjë që na intereson neve si politikë, sa kohë e kemi në dorë që me konsensus ta bëjmë këtë gjë. Duhet të shmangim mundësinë e goditjes të procesit më pas nga të tretët.

Po themi një konsideratë të fundit, e përgjithshme, pa hyrë pastaj në çështjet problematike që ne mendojmë se duhen trajtuar. Nisur gjithmonë edhe nga fakti që është një proces i jashtëzakonshëm, është një proces i cili nuk ka një model të qartë dhe një standard, saktësia dhe detajimi i ligjit në përgjithësi në çdo aspekt, jo vetëm në aspekte të teknikës, por dhe në aspektin

e referencave me ligje të tjera, ku shpeshherë i janë referuar ligjit, të cilat janë ende në proces draftimi, do të bënte që, nëse do të ecet me këtë tekst kështu siç është, me këtë cilësi që ka sot, ne mund të gjendemi përpara një ligji që nesër mund të prodhojë konfuzion serioz, apo dhe të rëndë, e për rrjedhojë të cenojë sigurinë juridike që u duhet si pakt ligjeve të tjera këtij ligji. Sa më shumë ta garantojë këtë nëpërmjet një ligji të shkruar mirë, qartë, pa probleme, pa konfuzione, pa konflikte me norma të tjera, aq më shumë ne kemi garantuar një punë të suksesshme të këtij procesi të vetingut. Këto ishin në aspektet makro. Besoj se shpejt do të referoj përsëri te çështjet në mënyrë më të detajuar në lidhje me këtë që sapo thashë të këtij projektligji dhe që më pas ekspertët do të shkëmbejnë konsideratat teknike për çdo paragraf, ku në këndvështrimin tonë ka probleme serioze, të rëndësishme, apo probleme që duhen diskutuar për të gjetur zgjidhje më optimale. Ne mendojmë se teksti i projektligjit, siç e thashë, nuk detajon procedurën e përzgjedhjes dhe emërimin e anëtarëve të organeve të vetingut, si dhe procesin e vlerësimit të kandidaturave, duke e lënë këtë proces në diskrecionin e organeve të përfshira në procedurë.

Nga ana tjetër, projektligji nuk detajon rastet e përjashtimit të kandidatëve nga konkurrimi, mënyrën dhe arsyet e këtij përjashtimi, si dhe të drejtën e ankimit për përjashtim.

Kjo do të kërkonte detajim të plotë në ligj të kriterëve, duke përfshirë, siç është rënë dakord më përpara, pra, të kenë kriterë ndaluese edhe për gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit e periudhës së komunizmit. E kemi diskutuar në seancën kur miratuam Kushtetutën. Pra, të gjitha këto kriterë, që kemi rënë dakord, të jenë të përfshira në mënyrë të qartë në ligj.

Gjithashtu, gjykojmë se roli i vëzhguesve ndërkombëtarë, i operacionit ndërkombëtar i monitorimit duhet të jetë në përputhje të plotë me atë që ne tashmë kemi rënë dakord në tekstin kushtetues, në atë që është votuar dhe në datën 11 hyn në fuqi. Aty ne duhet të përputhim në mënyrë më të plotë të mundshme atë që kemi rënë dakord atje. Pra, ato kompetenca, ato zgjidhje që na erdhën edhe nga partnerët ndërkombëtarë, duhet ta kemi në ligj, në mënyrë që roli i tyre të jetë i mirëpërcaktuar e për rrjedhojë të jetë edhe efikas.

Çështje tjetër me shumë rëndësi gjykojmë se është roli aktiv dhe përcaktues që kanë organet e kontrolluara apo nën vartësinë e pushtetit ekzekutiv, siç janë: ILDKPI-ja dhe DSIK-ja, dy organe, që janë qartas jashtë procesit të vetingut, qoftë në aspektin e profesionalizimit, qoftë në aspektin e integritetit, qoftë në aspektin e korrupsionit. Janë organe plotësisht në duart e ekzekutivit, dhe që të përfshihen në këtë reformë do t'i japë një kontroll tërësor Kryeministrit së paku në 2 nga 3 komponentët e procesit të vlerësimit, siç është kontrolli i pasurisë dhe kontrolli i figurës.

Përtej asaj, sa i aftë mund të jetë një institucion apo një tjetër për ta bërë në mënyrë të besueshme këtë, i gjithë procesi i vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës duhet të rikonceptohet në mënyrë që të japë të gjitha garancitë e nevojshme që të arrihet rezultati i pritshëm.

Masat e jashtëzakonshme të rivlerësimit duhet të zbatohen ekskluzivisht nga organet e posaçme të vetingut, pa asnjë rol aktiv, në mendimin tonë solid, të organeve ekzistuese të kontrolluara apo në varësinë e Kryeministrit.

Kemi ngritur një proces shumë të rëndësishëm, kemi ngritur një strukturë kushtetuese paralele të përkohshme, kemi pranuar ta bëjmë këtë edhe pse Komisioni i Venecias thotë që nuk është normale për t'u bërë dhe nuk do t'ia rekomandojmë askujt tjetër, por ne kemi rënë dakord që të jetë kështu.

Nuk e thjeshtuam sistemin, siç u ngrit çështja në fillim. I pranuar më vete, kemi rënë dakord për një proces kushtetues parlamentar shumë të rëndësishëm në emërimin e tyre me një debat shumë të madh derisa e miratuam me dakordësi dhe nuk mundet që këto të jenë organe, të cilat janë kukulla të një influence të drejtpërdrejtë të ekzekutivit në këtë proces.

I ngritëm këto që t'u japim të gjitha kapacitetet ligjore, financiare dhe burime njerëzore, për të kryer këtë detyrë në mënyrë efikase të plotë, pa asnjë dyshim, me transparencë dhe që shmang çdo lloj kontestimi më pas. Por parashikimi i këtyre dy organeve praktikisht është një kalë troje, që do të zhbënte procesin e vetingut dhe do ta kalonte nën kontroll të ekzekutivit. Është i gjithë debati që kemi bërë për Kushtetutën, dhe sigurisht këtë e nxjerr jashtë loje.

Një çështje tjetër është procesi dhe standardet e kontrollit të figurës që e bëjnë komponentin e vlerësimit, në gjykimin tonë, shumë subjektiv. Përdorimi i standardeve të tilla për shkarkimin nga detyra të një gjyqtari apo të një prokurori do të bënte ose shpeshherë mund të çonte në kufizime, të cilat mund të na çojnë ndesh me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Ne kufizimet i pranojmë edhe me nenin 17 të Kushtetutës. E kemi bërë edhe më përpara. Ligji i dekriminalizimit është një ligj që kufizon të drejtën. Kemi kufizuar edhe në raste të tjera, por ajo që është e rëndësishme është se ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm që të arrijmë qëllimin tonë të përbashkët politik për pastrimin e sistemit të drejtësisë, duke bërë kufizime në ekstremin e proporcionalitetit që na lejon Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Kështu që gjykojmë se është shumë e rëndësishme që në këtë proces t'i garantojmë këto aspekte, që do të çonin drejt një procesi të rregullt ligjor dhe do të na imunizonin nga goditja, nga individë, të cilët, me të drejtë, mund të hiqen nga sistemi, por që shfrytëzojnë dobësinë e ligjit për

ta goditur procesin. Ky nuk është objektiv politik i askujt prej nesh. Për rrjedhojë, duhet ta imunizojmë procesin.

Me qëllim që procesi i rivlerësimit dhe projektligji të jenë në përputhje me rekomandimet e opinionit të Komisionit të Venecias, vlerësojmë se duhet të përmbushen në mënyrë të njëkohshme parimet e procesit të rregullt ligjor. Prosesi duhet të identifikojë gjyqtarë individualë, që nuk janë të përshtatshëm për të mbajtur një post gjyqësor, gjyqtar apo prokuror, dhe të shoqërohet me masa që e garantojnë procesin e rregullt ligjor, në përputhje me atë që na thotë Komisioni i Venecias, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe standardi ndërkombëtar. Për këtë arsye të drejtat dhe liritë personale, të parashikuara në Kushtetutë, që kanë të bëjnë me privatësinë, me barrën e provës e të tjerë, duhet të jenë të përputhura me këto rregullime kushtetuese dhe me rekomandimin e Komisionit të Venecias, gjithmonë kjo në të njëjtën linjë me atë që thamë më parë. Pra, procesi të shkojë në maksimumin e proporcionalitetit, që na lejon kufizimi i këtyre të drejtave, që ne të jemi efikas në pastrimin e gjyqësorit nga korrupsioni.

Gjithashtu, gjykojmë se periudha e vlerësimit profesional nuk garanton mosndërhyrjen e organeve të vetingut në vendimmarrje konkrete për çështjet që kanë në dorë gjyqtarët apo prokurorët. Vlerësimi i aftësive për çështjet që lidhen me 3 vjetët e fundit të ushtrimit të detyrës nënkupton se vlerësimi bëhet edhe për çështjet që janë në shqyrtim gjatë periudhës së rivlerësimit apo edhe për çështjet që mund të jenë ende të pazgjithura në shkallët më të larta të sistemit gjyqësor.

Projektligji duhet të detajojë listën e plotë të komponentëve, që përfshin vlerësimin profesional. Në çdo rast vlerësimi profesional nuk duhet të përfshijë provime apo testime profesionale, por kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Komentet e detajuara janë te nenet përkatëse, por ne gjykojmë se ky aspekt është shumë i rëndësishëm. Pra, procesi i vetingut nuk mund të jetë kurrsesi një instrument që supreson, që shtyp pavarësinë e gjyqësorit dhe jep mundësinë e ndërhyrjes nga jashtë në vendimmarrjen e sistemit të drejtësisë në 5 vjetët apo 10 vjetët e ardhshme, sepse do të përdoret për të abuzuar jo vetëm për interesa politike, por edhe për interesa korruptive. Kështu që, në gjykimin tonë, këtu duhet bërë shumë kujdes.

Ne, gjithashtu, gjykojmë se koncepti i provës dhe i besueshmërisë apo objektiviteti që duhet të ofrojnë të dhënat dhe faktet që do të konsiderohen si provë, ka probleme të rënda, të cilat duhen marrë në konsideratë, sepse kështu siç janë parashikuar do të krijojnë probleme.

Lidhur me rregullimet e tjera, me ligjet e të njëjtës hierarki dhe që janë thelbësore në një proces, si koncepti i provës, ne jo vetëm do të kishim konflikt ndërmjet tyre, por do të krijojmë edhe mundësinë që procesi të ishte vulnerabël, i goditshëm nga personat që preken. Ne këtë nuk mund ta lejojmë për shkak se me punë të përbashkët mund t'i përcaktojmë qartë elementet se çfarë është prova në procesin e vetingut.

Gjithashtu, mendojmë se ka një deformim të qëllimit të sanksionimit në kriterin kushtetues, të ndalimit, të mbajtjes së funksioneve politike në administratën publike apo pozicionet hetuese në partitë politike. Ndërkohë, rregullimi në ligj është shtrirë te funksionarë të tillë si: këshilltarët e kabineteve, dhe funksionarë të ngjashëm. Rregullimi që ka ligji sot përjashton funksionet politike si ministër, zëvendësministër, deputet e të tjerë, që nuk janë drejtues organesh politike, të cilët, sipas gjykimin tonë, ky ligj nuk i klasifikon si funksione politike. Pra, ne mendojmë se ky është vetëm një koment dhe në mënyrë më të detajuar janë komentet e dispozitave, por nuk mundet që pjesa, kremi i kemit të asaj që ne do të donim ta pengojmë nuk u përfshika, sepse formulimi është i tillë që i lë jashtë, ndërkohë që nivele të tjera më poshtë nuk përfshihen nga ana tjetër. Sigurisht që ka edhe persona që sipas ligjit “Për shërbimin civil” mund të jenë funksionarë, pra konsiderohen si funksionarë kabinetesh politike, por në organe të pavarura kushtetuese si, për shembull, këshilltari i Avokatit të Popullit, i bie që me formulimet që kemi sot të mos përfshihet.

Nga ana tjetër, sigurisht që mund të bëjmë kujdes me atë që quhet *revolving doors* apo pantopolazhi, dikush nga institucionet, qoftë me mbështetje politike, kalon në fazën e emërimit, në fazën e ngritjes së këtyre institucioneve kalon te këto organe. Në këtë rast ka një lloj kufizimi, por këtu siç është organizuar ky aspekt ka probleme, sepse bën kufizime që janë ndoshta të pavend. Nga ana tjetër lë jashtë pjesë shumë të rëndësishme, ato që duhet të jenë ndalimet për t'u përfshirë në këto institucione.

Procesi, gjithashtu, mendojmë na lejon shmangien e transparencës në 5 legjislativat e tij, sipas vlerësimit diskrecional të organeve të përfshira në proces, duhet të sigurohet transparenca e plotë për publikun në çdo fazë dhe në veprimtarinë e organeve të përfshira në këtë proces.

Nëse ka një gjë që i intereson publikut në procesin e vetingut është kufizimi i transparencës që po ndodh. Çfarë po ndodh, si po kryhet, pse po bëhet diçka, pse nuk po bëhet diçka? Diskrecioni për të kufizuar transparencën është një element vrashtar për procesin e për rrjedhojë duhet riparuar sipas... Ne kemi bërë sugjerime shumë konkrete në lidhje me këtë aspekt.

Çështja e fundit: mendojmë se kompetencat e organit të vetingut duhet të specifikohen se bëjnë vetëm vlerësimin e përshtatshmërisë së emërimit të subjekteve të jashtme në sistemin gjyqësor. Ndërkohë, përfshirja e tyre duhet të jetë rrethanë përjashtuese në sistemin e drejtësisë, sipas rasteve të përcaktuara nga ligji, si dhe një proces konkurrimi i barabartë, apo i njëjtë me studentët normalë në Shkollën e Magjistraturës, duke parashikuar edhe detyrimin e ndjekjes së trajnimit fillestar. Pra, këta persona, nëse do të hyjnë në këtë proces, do të jenë thjesht përcaktimi i përshtatshmërisë, por jo siç e ka shkruar ky ligj, deri në dispozitat që i japin të drejtë institucionit të vetingut të bëjë edhe emërimin në funksionet e gjyqtarit apo prokurorit.

Kjo ishte çështja e fundit e rëndësishme që deshëm të theksonim në komisionin e sotëm. Besojmë se është shumë e nevojshme të trajtohen, qoftë në aspektin teknik, me qartësi të madhe dhe besoj se do të na japin mundësinë neve, që në mënyrë konsensuale t'i japim mbështetje gjithë kësaj.

Për sa u përket komenteve për dispozita konkrete, që fillojnë në nenin e parë dhe shkojnë deri në fund të këtij ligji, janë të detajuara në një dokument të plotë të përgatitur nga ekspertët e opozitës dhe, siç ramë dakord, zoti kryetar, ata mund të ulen që nga dita e sotme dhe të shkëmbejnë materiale, vërejtje, dhe propozime konkrete, në mënyrë që të ecet me shpejtësi dhe të kemi mundësi të ... Sigurisht që, sapo të shkëmbehen, do të jenë të disponueshme për të gjithë komisionin.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Unë bashkohem me idenë që nuk kemi një model të qartë për të pasur një referencë të ngjashme, por besoj se duhet të jemi korrektë kur flasim për çështjen e standardeve, sepse pjesërisht, ose për çështje të caktuara që lidhen me vetingun, ka disa modele ku është aplikuar, që janë realizuar nga ekspertët në tërësi dhe nga ekspertët ndërkombëtarë në veçanti. Por, natyrisht, edhe fakti që nuk ka një model të këtij standardi, nuk ka edhe një ligj që të përbëjë një standard për raste të ngjashme deri më sot, besoj se ka qenë kjo arsyeja që Drejtoria e Çështjeve Ligjore të Brukselit, por edhe Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të kenë qenë të involvuar drejtpërdrejt në vlerësimin e neneve të këtij projektligji, dhe në mënyrë të veçantë të aneksit kushtetues. Ka qenë një përgjegjësi e gjithanshme për të pasur një ligj që të jetë në përputhshmëri me standardet më të mira ndërkombëtare të funksionimit të shtetit të së drejtës.

Gjithsesi, përveç kësaj, duhet pranuar se në fazën që jemi kemi dy dokumente shumë të rëndësishme: opinionin shterues të Komisionit të Venecias, që besoj se është pranuar si opinion i

standardeve më të mira për shkak të peshës, vlerës dhe rolit që ka ky organizëm në vlerësim, në opinionet që jep për kushtetutën dhe legjislacione të vendeve të ndryshme.

Gjithashtu, kemi një favor tjetër të rëndësishëm në këtë fazë të procesit: projektin kushtetues që kemi miratuar së bashku, tërësisht konsensual me 140 vota në parlament, i cili, përveç rregullimit në dispozitat transitorë të tij, ka një aneks kushtetues të plotë, aq sa shpeshherë është gati i ngjashëm me formën e një ligji, pra i ka të detajuara çështjet që kërkon të zgjidhë ligji. Ndoshta është ndër normat kushtetuese më të zgjeruara dhe kjo jo pa qëllim, sepse ka dashur që projekti të marrë standard dhe garanci kushtetuese. Ne tashmë i kemi dhënë standard dhe garanci kushtetuese këtij procesi, të trajtuara në mënyrë shumë të hollësishme, aq sa mund të themi se Kushtetuta në këtë rast mund të zbatohet edhe drejtpërsëdrejti. Por, natyrisht, ligji është i nevojshëm për të sqaruar detaje, për të sqaruar procedura teknike, që do ta bëjnë shumë më të aplikuar parashikimin kushtetues të paraqitur në aneksin kushtetues të ndërtuar posaçërisht për çështjen e procesit të vlerësimit.

Pra, të marra si të tilla, analizat që janë bërë për aplikime të ngjashme për procesin e aplikimit të vlerësimit të vetingut në vendet e tjera.

Opinionet e Komisionit të Venecias dhe vetë shtjellimi që i ka bërë Kushtetuta këtij procesi, në aneksin kushtetues, janë një bazë e mirë solide, një kornizë që jo thjesht ndihmon, por nuk të lë të gabosh në hartimin e një ligji që është zbatues, siç është ky që po shqyrtojmë në lidhje me rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Kështu që i gjithë ky kuadër bazik t'i japë mundësinë këtij komisioni, ekspertizës, parlamentit që i gjithë ky projektligj të jetë në standardet më të mira, natyrisht dhe domosdoshmërisht, në përputhje me amendamentet kushtetuese të 22 korrikut.

Besoj se brenda ditës së sotme, ky projekt do t'i përcillet ekspertizës, kështu që ekspertët që do të caktohen nga grupi parlamentar, ose nga opozita, thënë ndryshe, do të jenë në kontakt me ekspertizën.

Për të vlerësuar të gjithë këtë proces, të gjithë këtë debat, këtu janë të pranishëm përfaqësuesit e BE-së, gjithashtu, edhe ekspertët e misionit EURALIUS, të cilët besoj kanë mbajtur shënimet e nevojshme për këtë parashtrim të përgjithshëm. Besoj se do ta marrin këtë dokument, (nëse nuk e kanë deri tani) në mënyrë elektronike brenda ditës së sotme, për t'u dhënë atyre mundësinë e përkthimit, nëse nuk është i përkthyer.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, do të duhet të përkthehet, të vlerësohet dhe të shqyrtohet në procesin që do të ndjekë vetë EURALIUS-i, OPDAT-i, apo zyrat e tyre respektive të Brukselit apo të Uashingtonit, që janë angazhuar në procesin e hartimit të këtij projektligji. Pasi të kemi marrë këtë opinion, do të mblihdemi përsëri këtu në komision për ta shqyrtuar.

Ndërkohë, lidhur me dy draftet e tjera, që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe me SPAKU-n, ne, po ashtu, kemi bërë një shqyrtim në parim dhe nen për nen në këtë komision. Është e vërtetë që ligji “Për qeverisjen”, besoj edhe ai i SPAKU-t, duhet të ketë dhe ka reflektime që lidhen me ndryshimet e fundit kushtetuese para miratimit të versionit final të projektit. Besoj se do t’u kërkojmë ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, që janë marrë me këto dy projekte, që t’i vendosin sa më parë në dispozicion të kolegëve deputetë, në mënyrë që secili të ketë mundësinë ta njohë projektin, të njihet me reflektimet e bëra nga drafti i shqyrtuar në komision dhe pastaj t’i hapet rruga procesit të shqyrtimit të tyre.

Do të ishte shumë mirë që për të shtata këto projektligje të bëhet kjo gjë gjatë kësaj kohe. E di që nuk është një kohë e lehtë për njerëzit, sepse është kohë pushimesh dhe temperaturash të larta. Ju kërkoj ndjesë, por jemi të detyruar, për shkaqe përtej nevojave për të pasur një ligj, por nevojës që kemi për ta sjellë ligjin, për ta bërë të aplikueshëm, të zbatueshëm për procesin, ose rregullimet kushtetuese, por, njëkohësisht, ne e kemi thënë dhe nuk është ndonjë mëkat ta ripërsërisim faktin që kjo lidhet edhe me një kërkesë që Brukseli ka bërë në prag të hapjes së negociatave.

Kjo është pak a shumë ajo që kishim për të diskutuar sot. Besoj se nuk ka vend për komente të tjera. Nuk do të ishte shumë korrekte t’i hynim një diskutimi për të cilin jemi dakordësuar paraprakisht, kështu që po u lë mundësinë ekspertëve, ndërkohë besoj se dokumentin do ta marrin edhe kolegët deputetë; ata kanë edhe draftin e paraqitur dhe do të japin të gjithë kohën e nevojshme, me qëllim që t’i kalojnë sa më mirë ditët e pushimeve që do të kenë në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbledhja e ardhshme e komisionit do të jetë e kondicionuar nga dy projektligjet e tjera, kur do të jeni ju gati për të paraqitur ekspertizën tuaj lidhur me përmbajtjen e projekteve.

Ne jemi të gatshëm t’ju dëgjojmë me vëmendje, si gjithmonë, sepse kemi respekt për opozitën edhe kur është, edhe kur nuk është këtu. Të jeni të sigurt që edhe kur ju e bojkotoni mbledhjen, ne jemi akoma më të vëmendshëm që t’ju trajtojmë sikur ju jeni këtu me ne, sepse cilësia e ligjit është ajo që duhet të na bashkojë.

Ne, gjithashtu, do të presim edhe kohën e nevojshme që ekspertët të njihen; të përkthehet dokumenti në anglisht dhe, njëkohësisht, ata të kenë mundësinë të konsultohen me njëri-tjetrin, edhe me misionet që ata përfaqësojnë për këtë ligj, sepse ky ligj nuk është thjesht punë për EURALIUS-in apo OPDAT-in, por është edhe për zyrat respektive përgjegjëse të tyre. Unë jam në dijeni të këtij fakti, sepse më është thënë zyrtarisht prej tyre, kështu që le ta bëjnë ata të gjithë këtë proces dhe të na njoftojnë që ne të mblidhemi.

Ne jemi të gatshëm; e kanë shprehur këtë të gjitha forcat politike. Kam dëgjuar të gjithë drejtuesit e partive politike gjatë kësaj kohe. Besoj se edhe kolegët që janë këtu, kanë të njëjtin qëndrim, që jemi të gatshëm të mblidhemi në çdo moment që ekspertiza do të jetë gati për t'u dëgjuar dhe për të diskutuar.

Faleminderit!

E mbyllim këtu mbledhjen.

Ditë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET